

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 27 SHTATOR 2004**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 27. SEPTEMBRA 2004.GODINE**

---

**SHTATOR - SEPTEMBAR**  
**2004**

# TRANSKRIPT

## NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 SHTATOR 2004

Seanca Plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,15.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes. Mirëseardhje në Seancën e rregullt dhe të fundit - të shpresojmë - për këtë mandat tonin.

Materialet ju janë shpërndarë me kohë.

Të pranishëm janë 79 deputetë, që do të thotë mund t'ia fillojmë punës.

E ka fjalën deputeti Ahmeti. Urdhëroni...

### HALIL AHMETI:

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, e nderuara Kryesi e punës, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,

Unë kam parasysh kohën të cilën e marr për të bërë një deklaratë, besoj të rëndësishme në përmbylljen e punimeve të Kuvendit të Kosovës - brenda këtij mandati që po e lëmë pas.

Deklarata ka të bëjë me një projekt, për të cilin - gjatë mandatit tim si deputet, përveç punëve dhe obligimeve tjera, ia kam kushtuar pjesën më të madhe të kohës.

Me plotë bindje se artieria, apo vija Dezentia antike, e tani e emërtuar korridor Adriatik-Alpe në një të ardhme - jo të largët - do të bëhet realitet, unë si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe deputeti i Parlamentit Shqiptar - zoti Azgon Haklaj kemi marrë guximin dhe i kemi hyrë një punë jo të lehtë, pra për jetësimin e Projektit kapital për Kosovën, Shqipërinë dhe rajonin, pas autostradës Prishtinë-Prizren-Durrës, e kjo është arteria përkatësisht rruga magjistrale Ponošec-Qafë- Morinë-Fierzë-Komon-Krye-Bushat-Shën-Gjin.

Në shumë takime, të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, me plot të drejtë është quajtur magjistrale e shpresës dhe të shpëtimit të trevave të copëtuara dhe të katandisura shqiptare për një shekull, të izoluar midis tyre, duke kushtëzuar një prapambetje dhe varfëri të skajshme.

Fjala është për rëndësinë dhe rolin që do ta luajë kjo magjistralë në nxitje të bashkëpunimit komplementar midis trevave të shkëputura dhe të izoluara shqiptare për shkak të ngritjes së kufijve të padrejtë, me pasoja të dezintegritimit dhe izolimit shekullor, ndarjes me botën e zhvilluar e gjithësesi për shkak të mungesës së rrugëve bashkëkohore që duhej t'i lidhnin këto treva midis tyre me botën e qytetruar. Edhe sot e kësaj dite, këto treva shqiptare, paraqesin viset më të prapambetura dhe më të varfëra në Evropë.

Pasojat shumëdimensionale, mund të tejkalohen krahas integritimit në suaza të tërësisë etnike - sipas modelit të Unionit Evropian, në të cilin proces padyshim rol të rëndësishëm do të luajë lidhja dhe zhvillimi i komunikacionit rrugor dhe hekurudhor – pra i magjistralës via Dezentatani korridori Adriatik-Alpe, i cili lidhte këto treva dhe rajonin që nga lashtësia.

Angazhimi i vazhdueshëm i të dy deputetëve të të dy parlamenteve, me përkrahje të presidentëve Rugova dhe Moisiu, ministrave Morina, Poçi, Majko, pushtetit lokal të të dy vendeve, shoqatave Shkodër-Bajram Curr-Gjakovë – rezultatet janë evidente, e sidomos pas Simpoziumit të mbajtur në Shkodër dhe Gjakovë, takimeve të vazhdueshme, dhe me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare - ky projekt po shkon drejt realizimit.

Kanë mbetur edhe 34 kilometra për t'u hapur rrugë e re Bregut të Drinit dhe për t'u bërë realitet, pra një rrugë komplementare e rëndësishme për Kosovën, Shqipërinë dhe tërë rajonin duke u lidhur me Portin e Shën-Gjinit dhe në anën tjetër me Malin e Zi përkatësisht magjistralen e Adriatikut.

Projekti në fjalë ka gjatësinë 157 kilometra, duke filluar nga Ponosheci-Gjakovë e deri në Shën-Gjin.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Transportit, kanë ndarë mjete për pjesën e Kosovës dhe për momentin janë afër përfundimit të punimeve, ndërsa Qeveria Shqiptare po ashtu ka ndarë mjete për asfaltimin e 14.5 kilometra nga Qafa e Morinës deri në fshatin Sopot. Banka Botërore ka bërë investime në rikonstruktimin e rrugës Krye-Bushat të Shkodrës – Komon.

Të nderuar deputetë, pas Simpoziumit në Gjakovë, të mbajtur më 26.06.2004, me përkrahje të institucioneve vendore, përkrahjen tuaj dhe përkrahjen pa rezervë të kryetarit të Kuvendit – zotit Daci, ju njoftoj se deri më tani dokumentin për përkrahje të Projektit Adriatik-Alpe e kanë nënshkruar 77 deputetë, do të thotë nga të gjitha partitë politike dhe nga minoritetet.

Me këtë rast, dua t'ju lus që me një votë formale të aprovohet kjo deklaratë rreth Projektit të korridorit Adriatik-Alpe, si projekt i një rëndësie të veçantë për Kosovën dhe rajonin në tërësi. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Do të doja t'i them nja dy-tri fjalë lidhur me këtë. Deputetët e theksuar kanë bërë një punë shumë të rëndësishme dhe nuk e kanë kursyer asnjë moment veten dhe gjithmonë kanë dërguar raporte për sukseset e arritura. Mendoj se Parlamenti përkrah çdo punë të deputetëve të saj, ndërsa procedurat nuk lejojnë që ne të kemi votë të tillë, por të gjithë jemi për përkrahje të një pune të madhe që e ka bërë deputeti Ahmeti me deputetët e Shqipërisë.

Propozoj të kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës të aprovuar.

Ka kërkesa për heqje nga shqyrtimi i sotëm të pikës 8, pikës 12 dhe pikës 13 të rendit të ditës për shkaqe të arsyeve të ndryshme teknike, përmbajtësore dhe të mosarritjes së konsensusit të caktuar. Prandaj, mendoj se duhet pranuar ky propozim. Zoti Naim Maloku e kërkon fjalën.

NAIM MALOKU:

Unë kisha për të lutur të sqarohet pse të hiqet nga rendi i ditës Projektligji për mbrojtjen e natyrës.

Njoftoj deputetët, dhe juve zoti kryetar, se Komisioni parlamentar për mjedis dhe planifikim hapsinor ka kryer punën e vet në shqyrtimin e këtij Projektligji. Amendamentet janë dorëzuar me kohë, dhe deputetët i kanë para veti. Ju njoftoj po ashtu se gjatë shqyrtimit – për ndihmë Parlamentit të Kosovës – i është bërë lutje Zyrës së Bashkësisë Ekonomike Evropiane, pastaj janë harmonizuar amendamentet edhe me hartuesin e Projektligjit dhe gjatë tërë kohës kanë qenë pjesëmarrës përfaqësuesit e Ministrisë dhe mendoj se nuk është mirë që ky Projektligj të hiqet nga rendi i ditës.

Kosova - me këto amendamente, me këtë Projektligj, do të ketë një ligj solid për mbrojtjen e natyrës. Gjatë kësaj pune janë marrë në konsultim Ligji kroat për mbrojtjen e natyrës, Ligji i Gjermanisë Federale. Prandaj i njëjti është në harmoni me standardet e Bashkësisë Ekonomike Evropiane. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kam vetëm informacionin se nuk është arritur pëlqim që siguron konsensus, dhe për t'u sqaruar kjo do t'na merr kohë, prandaj mendoj se vetëm këtë përgjegje mund t'ua jap, dhe nuk e shoh të arsyeshme të hapim debat lidhur me këtë. Urdhëroni, prap Naim Maloku.

NAIM MALOKU:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,  
Gjatë shqyrtimit të Projektligjit, në Komisionin parlamentar kanë qenë të pranishëm shumica absolute e Komisionit – përfaqësues deputetë nga të gjitha partitë politike, kuptohet përveç koalicionit "Kthimi", i cili po e bojkoton Kuvendin e Kosovës.

Me këtë rast, më lejoni, zoti kryetar, t'ju njoftoj juve dhe Kuvendin se të gjitha amendamentet që i keni para veti sot e kanë marrë pëlqimin unanim të Komisionit parlamentar, pra të të gjithë anëtarëve të partive politike që kanë qenë prezent, që këtu janë ata anëtarë të Komisionit.

Amendamentet janë të harmonizuara, dhe për herë të parë dëgjoj se diçka nuk është harmonizuar!?

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Jo Tomë, nuk do t'hapim debat. Unë e kam kërkesën e Grupit Parlamentar, më të madh dhe kur ju them diçka – me përgjegjësi të plotë e them, nuk është mendim i imi për t'u hequr apo vendos diçka në rend dite.

Është një rend dite me mjaft pika dhe mund të humbim një orë lidhur me këtë çështje dhe prap të mos bëjmë zgjidhje. Prandaj, ju lutem për mirëkuptim dhe gjatë kësaj Seance të fundit të mos humbim kohë apo energji. Zoti Çelaj, e ka fjalën.

LIRAK ÇELAJ:

Unë desha sqarim më shumë për pikën 12 – Projektligjin për teatrin dhe cilat janë arsyet për heqjen prej rendit të ditës kur Komisioni ka punuar dhe proceduar me të gjitha rregullat. Kemi qenë prezent në mbledhje dhe të përfaqësuara të gjitha partitë dhe kemi bërë punë të madhe, përveç “Kthimit” që u cek edhe nga parafolësi. Askush nuk e pat kundërshtuar këtë ligj. Ka mund të ketë ndonjë amendament për të cilin kemi diskutuar, por për shumicën jemi pajtuar dhe unë nuk e shoh të arsyeshme për diçka teknike - po mendoj - dhe të hiqet nga rendi i ditës. Tjetër është se a do të kalojnë amendamentet apo jo, kurse kjo besoj është mirë të procedohet në rend dite dhe të votohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Për t’mos u përsëritur. Është kërkesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës – e Ministrisë përkatëse që sot të mos procedohen. Po, Edi, unë e thash të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike! Urdhëroni...

EDI SHUKRIU:

Më falni, po flas në emër të Komisionit. Siç tha nënkryetari i Komisionit, anëtarët e Komisionit gjatë amendamentimit nuk kanë patur kurrfarë mosmarrëveshjeje lidhur me këtë. Prandaj, a rryetimi s e Lidhja Demokratike dhe Ministria përkatëse po k ërkon, më duket se duhet të dëgjohet këtu - që jo vetëm me kërkesën e tyre të hiqet kjo.

Mund të them se krejt puna e Komisionit që ka qenë - ka qenë që çështja e teatrit sa t’mund të decentralizohet dhe jo të jetë për shumë vendime në kompetenca të ministrit.

Prandaj, insistoj që ta dijmë arsyen lidhur me këtë, sepse – pas gjithë asaj pune të madhe të Komisionit - dojmë ta dijmë arsyen pse të bëhet kjo. Argumentimin, ju lutem! Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë nuk kam të drejtë, sipas postit tim, të kërkoj dikush ta marrë fjalën dhe ta sqarojë këtë. Ashtu si më obligon procedura, me insistim të deputetëve, mund ta vë në votim. Por, po ju lus se për këtë s’kemi nevojë, sepse rezultati paraprakisht dihet. Unë thash, është kërkesë e qartë. Por, meqë doni, atëherë, duhet ta ndjek procedurën... Urdhëroni zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Unë dua ta theksoj qëndrimin e Grupit Parlamentar. Dihet se ne jemi në këtë Seancë faktikisht në fushatë zgjedhore dhe ne i kemi lënë të gjitha obligimet për t’ardhë e kryer detyrën si deputetë dhe infrastrukturës ligjore të Kosovës t’ia bashkëngjesim edhe këto ligje të mbetura.

Nëse këto hiqen, e këto ligje nuk miratohen në këtë mandat, edhe ne jemi kundër heqjes së këtyre ligjeve nga procedura, sidomos të atyre ku që Ministria – sponsoruesi, dhe Komisioni – e kanë kryer detyrën e vet.

Në rast se ka mospërputhje ndonjë amendament me ndonjë ligj tjetër, atëherë mund t' mos votohet ndonjë amendament, por është e pakuptimt të hiqet nga rendi i ditës – për shembull – ligji për mbrojtjen e natyrës, apo edhe ligjet tjera kur sponsoruesit ose komisionet nuk e kërkojnë një gjë të tillë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministri, zoti Brajshori e ka fjalën.

BEHXHET BRAJSHORI:

Zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë,  
Shkurtimisht do ta paraqes arsyen pse kam bërë kërkesë që të tërhiqet ligji për teatrin dhe t'ju them të drejtën, ne e kemi bërë propozimligjin, kurse gjatë amendamentimit të ligjit Ministria nuk ka qenë e ftuar fare t'i harmonizojë qëndrimet me Komisionin.

Pasi marrjes së amendamenteve, kemi pa se ligji substancialisht është varfëruar me amendamente dhe nuk bën asgjë për të mirë – përkundrazi vështirëson jetën në përgjithësi teatrore në Kosovë.

Prandaj, më mirë është të bëjmë një ligj i cili hyn në funksion të zhvillimit të jetës teatrore dhe të zhvillimeve tjera në Kosovë sesa të bëjmë diçka që e ngulfatë jetën në Kosovë dhe i cili do të jetë më i keq sesa që është propozuar. Dhe, kërkoj që të tërhiqet dhe të mbetet për seancat tjera të Parlamentit të ardhshëm. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mendoj se ka mjaft arsye që të aprovohet propozimi për heqje nga rendi i ditës. Në qoftë se insiston ndonjë grup parlamentar ta marrë fjalën, le të urdhërojë.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari zoti kryetar,

Ne kemi krijuar një praktikë parlamentare se kur kërkohet nga një grup parlamentar tërheqja e ndonjë ligji duhet të jipet një arsyestim pse bëhet kjo.

Unë e kuptoj se ministri ka drejtë deri në momentin e votimit ta tërheq ligjin. Ai e dha edhe arsyetimin. Mirëpo, këtu u tha se një Grup Parlamentar ka kërkuar tërheqjen e tri ligjeve nga procedura parlamentare. Ju lutem mos e hudhni në një votim thjesht atë, por ta dëgjojmë këtu një arsyetim pse po tërhiqen. Unë nisem prej pikës së 8. – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e vulave. Ky ligj nuk është kërkuar të tërheqet nga ministri - i cili ka prezentaur në leximin e parë, dhe në leximin e parë ky ligj ka marrë mbështetjen parimore.

Nëse vërtetë ndonjë ligj ka të meta përmbajtësore dhe teknike, atëherë këto të meta teknike asesi nuk i arsyetoj, sepse shërbimet e Kuvendit duhet të jenë funksionale dhe nuk mund të ketë arsye të gabime teknike se një ligj nuk është i përgatitur.

Në qoftë se ka vërejtje përmbajtësore, vërejtjet përmbajtësore përmirësohen në procedurat e leximit të dytë dhe në procedurat e amendamenteve. Nuk mundemi tash, për shkak se një Grup Parlamentar nuk e don një ligj, e ai të ndahet. Në qoftë se një grup parlamentar nuk është i kënaqur me një ligj, le të urdhërojë të paraqet amendamente. Është procedura e rregullimit të ligjeve kur nuk janë të mira në përmbajtje.

Nuk dëshiroj tash të ndikohemi nga efektet e fushatës zgjedhore dhe ta bëjmë këtë. Është mirë, megjithatë, të jemi korrekt. Këto ligje janë proceduar. Në këto ligje është investuar dhe këtë investim mos ta hudhim kaq lehtë, për shkak se duhet kohë ta ndërtojmë. Motivi pse ne po e mbajmë mbledhjen me datën 27, pra që po i thejmë praktikën parlamentare, është pikërisht për të plotësuar kuadrin ligjor të Kosovës. Tani mos të udhëhiqemi me motive ndoshta që nuk janë mjaft transparente dhe të qesim hije të keqe në punën tonë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën profesor Alush Gashi, në emër të LDK.

#### ALUSH GASHI:

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe duke patur parasysh se ka filluar fushata zgjedhore, lus kryetarin e Kuvendit që ta përcjellë kërkesën e Grupit Parlamentar me qëllim që kjo mos të duket pjesë e fushatës.

Përmendja e fjalës fushatë këtu, më shtyri që në kuadër të procedurave të ritheksoj edhe një herë vendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne kemi punuar me shumë përkushtim në të tri këto ligje, kemi dhënë mbështetje në parim në leximin e parë dhe si Grup Parlamentar kemi shqyrtuar amendamentet që i kanë ardhur Grupit. Ne jemi të bindur se të tri ligjet meritojnë që të jenë më të mira. Ne kemi ardhur në përfundim se amendamentet e ofruara për shqyrtim dhe votim sot bijnë në konflikt me ligjet tjera, bijnë në konflikt dhe kanë mjaft dualizma, prandaj kërkojmë nga Seanca plenare dhe nga kryetari i Kuvendit që të japë mundësi të përmirësimit dhe sot mos të shqyrtohen në këtë Seancë plenare.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar, zoti kryetar, kërkoj përfilljen e procedurave dhe hedhjen në votim të kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ju falemnderit shumë.

#### KRYETAR I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Në fillim ju luta dhe thash që në Seancën e fundit të këtij mandati janë bërë përpjekje, aty ku ka patur hapësirë, që të ruhet uniteti veprues. Dhe, ju i dëgjuat ato arsye për dhe kontra. Unë do t'ju lutja që të mos detyrohemi ta përdorim mekanizmin e votimit, sepse nuk ka nevojë. Po ashtu, unë do ta rrespektoj kërkesën e atyre që insistojnë për rend dite, por po ju them nuk shoh ndonjë mundësi që të shqyrtohen, pos që ta vëjmë në pikëpyetje mbarvajtjen e Seancës së fundit, në të cilën janë disa ligje dhe që është krijuar një unitet se janë të rëndësishme dhe se ne duhet t'i kontribuojmë kësaj garniture që ta lëmë me mas tepër ligje.

Prandaj, unë ju falënderoj, sepse e kam patur përkrahjen tuaj. Po e ceku, asnjëherë nuk kam vepruar për interesa personale ose vendim personal. Gjithmonë ka qenë vlerësimi i situatës së përgjithshme dhe cila ka qenë dobia, por në qoftë se patjetër insistoni ta vëjmë në rend dite dhe të mbeten për rend dite, unë do ta rrespektoj procedurën.

Mendoj se profesor Bajrami, sikur kam informata, për një pjesë të ligjeve ka patur mirëkuptim edhe për argumentet e tjerëve, por në qoftë se doni të përqahe mi këtu, është tjetër çështje...

Jo, unë e vë në votim, s'ka problem dhe s'ju pengoj. Urdhëroni Dugolli...

#### BUJAR DUGOLLI:

Ju kisha lutur të jemi konstruktiv. Tash ne kemi vetëm një ligj i cili u tërhoq nga sponsoruesi dhe ne rrespektojmë vendimin e sponsoruesit, edhe pse mund të kemi vërejtje pse nuk është ftuar gjatë kohës së amendamentimit. Por, sa i përket 13-shit dhe 8-shit, nuk ka kuptim të tërhiqen. Ju mund ta hudhni në votim, kjo mund të mbivotohet nga LDK, por ne s'pajtohemi me këtë, sepse – sidomos ligji për mbrojtjen e natyrës – nuk ka kurrfarë arsye të tërhiqet. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edhe një herë profesor Bajrami, në emër të Grupit.

#### ARSIM BAJRAMI:

Dëshiroj t'i sqaroj dy fakte. Këtu u tha se Grupi Parlamentar i LDK ka vërejtje, ka amendamente – sigurisht amendamente brenda Grupit. Grupi Parlamentar i LDK ka përkrah në parim këtë ligj – në leximin e parë. Dhe, nëse ka patur vërejtje, pse nuk i ka proceduar në formë të amendamenteve në leximin e dytë dhe ky ligj të bëhet më i mirë.

Nuk është e vërtetë se unë kam patur mirëkuptim. Përkundrazi, sot ne kemi patur Komisionin për çështje legjislative dhe s'jam pajtuar me heqjen am bllok. Domethënë, unë pajtohem që ligji mund t' mos jetë i mirë, por nuk pajtohem të kemi qasje jointucionale dhe me qëndrime e pozicione partiake t'i bllokojmë ligjet. Në qoftë se ligji ka qenë i keq, grupi parlamentar është dashur të sponsorojë amendamente dhe ta ndërroj përmbajtjen e ligjit. Jo tash të thotë, ne kemi vlerësime se ligji s'është i mirë dhe s'mund të rregullohet. Atëherë, pse e ka pranuar në leximin e parë?

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë, pastaj Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë dhe përfundon debati – shkujmë në votim.

#### HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,  
Unë përpiqem të kam mirëkuptim për arsyet që e bëjnë ministrin për t'ndërmarrë një hap të tillë. Por dua të tërheq vërejtjen në dy çështje: Kemi patur situata të ngjashme edhe më parë dhe ministrave nuk iu është lejuar të

shfrytëzojnë këtë instrument. Edhe për këtë ka një kohë kur mund të tërhiqet ligji, por jo në proces të kësaj shkallë në të cilën veç kemi arritur.



E dyta: Nëse është kjo arsyeja pse u dashka të tërheqet një ligj, n'çfarë pozite atëherë janë ministritë tjera, ose sponsorizuesit tjerë të ligjeve që i kemi në vijim. A janë informuar ata? A i kanë marrë me kohë amendamentet? A kanë patur mundësi ata të bëjnë ndërhyrje të duhura ose jo? Ju e dini – sa herë kemi tërhequr vërejtje për raportin që nuk po funksionon si duhet me Qeverinë, dhe është injoruar kjo.

Prandaj, unë propozoj që të shqyrtohen amendamentet dhe në amendamentim e sipër le të imponohen ato qëndrime që konsiderohen të drejta, por le t'mos bëjmë presedane parlamentare.

Dhe - në fund, e kam borxh ta them edhe një gjë. Le të shërbejë edhe kjo pak për të parë kush po e bën buçkurish procedurën tonë. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit shumë. Hydajet, për këtë të fundit, me një seancë nuk ka mundësi, tre vjet është pa kush e ka bërë atë. E ka fjalën Fatmir Sejdiu, i fundit.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Unë mbështes vetëm atë që është thënë edhe në fazë të mëhershme si kërkesë e Grupit Parlamentar dhe po a shtu mund të them se për pikën 8 të rendit të ditës kemi patur bisedë edhe në Komisionin për legjislacion - pak më herët dhe nuk është arritur pajtim që të procedohet në këtë mënyrë. Ka qenë gati kundërshtim i plotë i të gjithë anëtarëve, jo ndoshta i të gjithë anëtarëve të Komisionit, por i shumicës së anëtarëve të Komisionit dhe zoti Bajrami këtë e ka parasysh, ju lutem.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Replikë, jo diskutim të lutem. Ta ka përmendur emrin...

ARSIM BAJRAMI:

Replikë! Së paku kërkoj nga kolegët e profesionit, siç është edhe profesori Sejdiu, që të jetë profesionist e të mos jetë një zëdhënës politik. Ai e di shumë mirë mënyrën se si mund të rregullohet ligji. Ai e di për shkak se është anëtar i Kryesisë dhe ne këtu po ndërtojmë një filozofi institucionale.

Në qoftë se vërtetë ka patur defekte, nuk prejudikoj që nuk ka patur defekte, pse ato defekte nuk janë shfrytëzuar dhe përmirësuar në mënyrë institucionale me amendamente. Tash na del se në leximin e parë ligji ka qenë në rregull, është pranuar – por më vonë – dikush e ka zbuluar se nuk është në rregull. Kështu, më së paku duhet që, ne që jemi jurista, të jemi vërtetë në nivel të profesionit që kemi.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Replikë – Fatmir Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

E kuptoj thirrjen e zotit Bajrami, por të njëjtën gjë ia kam thënë pak më herë unë atij. Pikërisht, është kërkesa që të kontribojmë bashkërisht për ta krijuar një atmosferë të përbashkët pune dhe ta përmbylim këtë seancë ashtu siç kemi vepruar të gjithë kohën. Ju lutem!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Ju lutem të përcaktohem.

Kush është për që pika 8 e rendit të ditës – Projektligji për përdorimin e vulave, të jetë në rend dite sikur është radhitur, ju lutem ta çoni dorën.

Le të numërohen votat, ju lutem. Hydajet unë e udhëheq mbledhjen!

Po dua me ia plotësuar dëshirën Hydajetit për me i thënë që megjithatë ka të drejtë. Jo, jo – s'të kam kritikuar. S'ka replikë, sepse jam pajtuar me ty, dhe kemi hyrë Hydajet në procedurë. Urdhëro...

HYDAJET HYSENI:

Tri herë më është përmendur emri, tri herë kam të drejtë në replikë. Unë po ua them vetëm një fjali: vetëm le të dihet si mbeti, kush e pati të drejtë, sepse doli pak kush ka të drejtë e kush s'ka të drejtë, dhe le të vlerësohet ju lutem. Se shumë gabime po bën kryetari ynë - i pagabueshëm!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit anëtar i Kryesisë. Parlamenti dhe opinioni e din kush gabon më shumë e kush më pak. Falemnderit shumë.

Tani ju lutem të deklarohe.

Kush është për ta hequr nga rendi i ditës pikën e 8-të të rendit të ditës?

Le të numërohen votat. Hydajet, a je i kënaqur?

45 kanë votuar për ta hequr prej rendit të ditës, 30 për të mbetur në rend dite. Pika e 8-të, është hequr nga rendi i ditës.

A doni të votojmë edhe për tjerat? Apo, do ta kryejmë me kaq.

Hydajet, qysh ke qef, sepse i ndjek procedurat dhe nuk po e pyes profesorin por ty?

HYDAJET HYSENI:

Unë do të dëshiroja që ne, nëse jo në këtë përbërje, se është tepër vonë – zoti kryetar, në përbërjen tjetër të sigurojmë një instrument tjetër që s'pyet për qefin e Hydajetit apo tjetrit, por që shikon rregullat, procedurat. Prandaj, vetëm le të rrespektohen procedurat, ju lutem.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Kush është që të heqet nga rendi i ditës pika 12 – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrin?

Mund t'i numëroni edhe ju votat, por ato i numëron Sekretaria.

A doni t'ju pyes: kush është për të mbetur kjo pikë në rend të ditës, që ta ndjekim procedurën e Hydajetit.

Kush është të mbetet në rend dite pika 12?

4 vetë janë për të mbetur. 47 janë për ta hequr.

Ju lutem, heqet prej rendit të ditës edhe kjo pikë.

Dhe, propozimi i fundit për heqjen nga rendi i ditës të pikës 13 – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Kush është për? Ju falemnderit.

Unë që më herët ju luta të mos humbim kohë, por meqë insistuat - e bëmë këtë.

Bujar, 45 deputetë janë për ta hequr nga rendi i ditës!

Vazhdojmë punën me rendin e ditës. Urdhëro Gani.

#### GANI KOCI:

Meqë filluam me heqje të pikave nga rendi i ditës, për pikën e 17-të - qëndrimin e Grupit Parlamentar e dini shumëmirë, dhe nëse nuk e heqni nga rendi i ditës do t'mbetni pa kuorum!

Këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në seanca tjera, prandaj edhe qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës e dini. Vetëm desha një paralajmërim, meqë filloi me heqje të pikave të rendit të ditës.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë, ju falemnderit. Për këtë duhet të mendojmë. Urdhëro Bujar.

#### BUJAR DUGOLLI:

Edhe unë pajtohem për pikën e 17-të, por kërkoj që pika e 15-të të heqet pasi u fillua kështu me heqje, sepse ne shqyrtojmë një mocion të një paneli që e ka bërë koalicioni "Kthimi" e i cili e bojkoton Kuvendin e Kosovës që një kohë të gjatë dhe mendoj se duhet të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës. Këtu nuk është as Koalicioni i "Kthimit" dhe ky panel s'ka nevojë... Ne nuk i kemi votuar këto asnjëherë, prandaj edhe për 15-shin kërkojmë të heqet nga rendi i ditës.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kur të vijmë atje Bujar, sepse tash e kam tjetër formë me shkrim, prandaj kur të vijmë te ajo pikë mund të propozojmë të heqet.

#### (NË VAZHDIM, SEANCËN PLENARE E KRYESOI BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU)

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Vazhdojmë me – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për financimin e partive politike ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për financimin e partive politike përmbajnë implikime buxhetore, por janë të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për financimin e partive politike me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Prandaj, të nderuar deputetë, shkojmë radhazi sipas amendamenteve.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Konstatoj se u miratua amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Konstatoj se u miratua amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Konstatoj se u miratua amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Konstatoj se u miratua amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 votë kundër.

A abstenon kush? Askush.

Konstatoj se u miratua amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Urdhëroni, nëse don për sqarim ndokush? Urdhëro zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Këtu duhet të kërkojmë sqarim, sepse Komisioni funksional nuk është deklaruar për këtë. “Vendet e rezervuara të financohen si vende të fituara” kjo është e pakuptimt, prandaj kërkojmë sqarim për këtë çështje të amendamentit 6, para se ta votojmë.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ke të drejtë. Kërkoj sqarim nga Komisioni. Urdhëroni zoti Berisha.

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryesues, amendamenti i ofruar në radhitjen e amendamenteve për Projektligjin për financimin e partive politike numër 6, që është dhënë në emër të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, nuk është tekst i cili është miratuar në Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që më vonë është ofruar me nënshkrimin e kryesuesit të takimit të këtij Komisioni teksti i cili është miratuar në Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, e ku thuhet: “10 për qind të mjeteve të fondit për demokratizim ndahen mes partive politike të përfaqësuara në Kuvend sipas numrit të deputetëve”. Kjo do të thotë se teksti i ofruar në versionin e parë është tekst i falsifikuar, dhe jo ai që është miratuar në Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Teksti i miratuar është ky (e tregon dorëngritur), dhe Kuvendi do të duhej të deklarohet për këtë tekst të amendamentit.

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ndoshta do të duhej një sqarim nga Sekretaria. Dhe, ju lutem të keni durim. Një moment, sepse presim tekstin zyrtar.

(Sekretaria arsyeton dhe sqaron çështjen e tekstit – S.Berishës)

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

A mund të vazhdojmë me amendamente tjera, derisa të vjen radha te amendament në fjalë?

Vazhdojmë me komisionet tjera, kurse për amendamentin 6 kthehemi më pastaj.

Ju lus, sikur më bëhet me dije, për amendamentin në fjalë, janë bërë korrigjimet më vonë dhe ai material ju është shpërndarë. Ky është teksti që propozohet nga nënkryetari i Komisionit të komuniteteve.

(Në ndërkohë një pjesë deputetësh e lëshojnë sallën)

(Prej së largu – pa kyçje të mikrofonit: O kryesues - shikoje a ke kuorum?)

Tash unë e shikoj a kemi kuorum!

Lus Sekretarinë ta bëjë numërimin e pjesëmarrjes së deputetëve në sallë.

Por edhe lus deputetët që të kthehen në sallë.

Momentalisht në sallë janë 58 deputetë.

Tani do ta japim një pauzë gjysmëorëshe, por njëkohësisht konstatojmë se kemi arritur të amendamenti numër 6 në Projektligjin për financimin e partive politike.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Të vazhdojmë me punën. Kuorum pune kemi. Prandaj, para se të kalojmë në aprovimin e amendamentit, të cilin e kishit në diskutim, t'ju them se më tutje për këtë Seancë nuk ka transmetim televiziv, dhe përqëndrohuni në punë. U mundova në mëngjes t'ju them se teknikisht t'ju çliroj, por nuk deshtët dhe unë e pagova më së shtrenjti.

Kalojmë në miratimin e amendamentit.

Profesor, ti e ke udhëhequr punën lidhur me këtë amendament, prandaj vazhdo më tutje.

#### FATMIR SEJDIU:

Një sqarim, të nderuar deputetë. Intervenimi që bëri nënkryetari i Komisionit të komuniteteve me tekstin e tij, është një intervenim që nxjerr besnikërinë e tekstit të formuluar në Komision. Ishte një marrëveshje e përbashkët edhe e kryesuesve të grupeve parlamentare dhe natyrisht disa nga anëtarët e Kryesisë që ishin prezent. Prandaj, në variantën e dërguar në Sekretari më 18 shtator 2004 e keni këtë tekst, dhe gabimisht është përcjell kjo variantë, në vend të amendamentit të radhitur 6 e keni këssoj dhe besoj se iu është shpërndarë deputetëve – Mikel?

Ju lutem, thuhet kështu: në nenin 5 pikë 2, riformulohet si vijon: "10 për qind e mjeteve të fondit për demokratizim ndahen mes partive politike të përfaqësuara në Kuvend sipas numrit të deputetëve". Ky është teksti, dhe ju lutem të procedojmë më tej. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. S'ka më debat Fatmir ... Urdhëro – urdhëro!

#### FATMIR REXHEPI:

Unë kërkoj falje, por Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, në të dy variantet që i ka propozuar, edhe në të parin që e kemi dhe në këtë të dytin që u tha këtu, përkundrazi do të thotë i dëmton vetë komunitetet. Prandaj, unë ju lus ta keni parasysh se më mirë është në Projektligj që 10 për qind të mjeteve të ndahen proporcionalisht për partitë në Parlament dhe të marrin më shumë mjete komunitetet – partitë e komuniteteve, sesa kështu. Kështu ndahen 10 për qind të mjeteve për 120 deputetë, që do të thotë serish partitë e mëdha marrin mbi 50 për qind të mjeteve. Vetëm për këtë sqarim dhe nëse doni ndërrojeni...

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Megjithatë, ju lutem nuk ka debat. Grupet parlamentare, anëtarët e komisionit, anëtarët e Kryesisë dhe sikur e sqaroi Fatmiri këtë, kanë arritur marrëveshje dhe mua më obligon kjo që ta vë në votim, për çka është edhe kryetari i Komisionit të buxhetit.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.  
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.  
A ka abstenim? 2 abstenime. Ju falemnderit.  
Kalon amendamenti, sikur që e lexoi profesori.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.

Urdhëro, urdhëro Gani!

(Sipas përcjelljes së inçizimit në CD – prej këtu paraqitet ndërprerje)

(Pas ndërprerjes)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Megjithatë, unë ju pyes:

- Kush është për Komisionin funksional? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? 4 abstenime.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? 1 abstenim.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? 1 abstenim.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? 1 abstenim.  
Kalon amendamenti.

Ndërhyerja e shefit të Grupit Parlamentar të AAK është me vend, prandaj ju ftoj të deklarohe mi lidhur me amendamentet prej 11 deri 12 që janë të Komisionit funksional.

Kush është për?  
A ka votë kundër? Asnjë votë kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim. Ju falemnderit.

Ju ftoj ta votojmë ligjin e amendamentuar.

Kush është për?

A ka votë kundër? Është një votë kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim. Ju falemnderit.

Konstatohet se Ligji është i aprovuar.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Shumica – Većina - Majority

Kundër – Protiv – Against.....01

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....01

---

Numri i deputetëve është 77. Falemnderit sekretar. Unë ju thash në fillim kemi kuorum - me kartelën tani të paraqitur numër 73, edhe pse disa i kanë harruar.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për veprimtarinë kërkimore-shkencore ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore përmbajnë implikime buxhetore, por janë të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe të njëjtat i përkrah, me përjashtim të amendamentit 3, të cilin nuk e përkrah.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për veprimtarinë kërkimore-shkencore me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush?

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A dëshiron për të 2-tin a të 3-tin? Mirë, këtu e ke shkruar për 3-shin. Urdhëro.



HAKI SHATRI:

Mirë. Meqenëse e mora fjalën po vazhdoj. Komisioni për buxhet, siç po shkruan në raport, nuk ka përkrah versionin e parë të amendamentit në fjalë të Komisionit funksional, por në konsultim dhe bashkëpunim me Komisionin funksional, jemi pajtuar që me një riformulim, për të cilin janë pajtuar të dy komisionet – ky amendament mund të përkrahet.

Teksti i riformuluar do të tingllonte: “Neni 7 pikë 1: – “për sigurimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme ndahen deri 0.7% e buxhetit të Kosovës. Këto mjete shfrytëzohen për financimin e...” dhe vazhdon teksti i nenit në fjalë.

(Ndërhyerje nga vendi – pa kyçje të mikrofonit)

(Sipas përcjelljes së CD – ka ndërprerje të shkurtër të inçizimit)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kush është kundër? Nuk ka votë kundër.  
A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.  
Kalon.

E tani jemi te amendamenti 3, për çka foli kryetari i Komisionit të buxhetit. Komisioni funksional ka propozuar 0.4% por me marrëveshje pastaj, thotë deri në 0.7 që është mundësia edhe më poshtë se 0.4% por edhe më shumë, varësisht prej... Unë e kuptova mirë, prandaj mendoj se ndërhyerja nuk e dëmton amendamentin e Komisionit funksional. Po, urdhëro – urdhëro, qysh jo.

HAJREDIN KUQI:

Falemnderit zoti kryetar. Ne pasi kemi marrë sqarimet e nevojshme, meqë edhe nuk jemi aq ekspert të buxhetit, më duket se rregull buxhetore është të caktohet pika më e lartë, e jo pika më e ulët dhe mbi bazën e saj nuk e di a është mirë të jetë pika më e lartë – 0.7, por me siguri se pika më e ulët nuk mund të jetë. Pra, pajtohem edhe me ndryshimin që mund të bëhet. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti kryetar falemnderit shumë.  
Kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalon.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 A abstenon kush? Nuk abstenon.  
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.  
 Kush është për? Ju falemnderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 A abstenon kush? Nuk abstenon.  
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.  
 Kush është për? Ju falemnderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 A abstenon kush? Nuk abstenon.  
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.  
 Kush është për? Ju falemnderit.  
 A ka votë kundër? Nuk ka.  
 A abstenon kush? Nuk abstenon.  
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, deputeti Behxhet Brajshori.

Pyes – a ka përkrahje nga komisionet?

Urdhëro, së pari Komisioni funksional. Urdhëro profesor.

#### HAJREDIN KUQI:

Falemnderit. Unë mendoj se amendamentet 8 dhe 9 kanë ngjashmëri njëri me tjetrin. Arsyeja është se, si duket propozimi i ministrit rrespektivisht i deputetit

Behxhet Brajshori ka patur parasysh gjendjen ekzistuese të instituteve dhe në qoftë se do të miratohej ai sikur është do t'i mbyllnim dy-tri institute.

Mendoj se ne duhet ta rrespektojmë gjendjen ekzistuese dhe të krijojmë mundësi që ato të funksionojnë e të forcohen edhe më tutje.

Edhe unë personalisht përkrah propozimin e deputetit Behxhet Brajshori, sikur që mendoj se amendamenti numër 9 duhet të tërhiqet në tërësi, nga se nuk është i njëjtë me fjalën “tituj shkencor” dhe “doktor shkence”. Pra, kemi institute që kanë njerëz me tituj shkencor, por nuk kanë doktor shkence të mjaftueshëm. Prandaj mbi këtë bazë mendoj edhe a mendamenti 9 duhet të tërhiqet, kurse amendamenti 8 të përkrahet ashtu sikur ka propozuar edhe deputeti Behxhet Brajshori. Falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Buxheti? Urdhëro Haki.

HAKI SHATRI:

Falemnderit. Ne me këto propozime pajtohemi dhe nuk kemi kurgjë kundër me Komisionin funksional, por ndërhyerja jonë është lidhur me nenin 17 pika 2 e që ka të bëjë me plotësimin e nenit 17 pikë 2 dhe për këtë çështje jemi pajtuar me Komisionin funksional. Fjala është që të definohen institucionet private shkencore, që janë dy tipe dhe të cilat karakterizohen përkah forma e financimit dhe vetëfinancimit. Duhet që në ligj vetëm të definohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Për të tetëmbdhjetëshin, a?

HAKI SHATRI:

Jo, për nenin 17 pikë 2. Do të thotë jemi pajtuar, por për shkak të kohës... Si të doni, krejt në rregull.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, të shkojmë me amendamente. Do të thotë vullneti ekziston, por procedurën duhet ta respektojmë.

Amendamenti 8, i propozuar nga ministri dhe i përkrahur nga Komisioni funksional. Kjo vlenë të njëjtën kohë edhe për eliminimin e 9-shit, siç tha kryetari i Komisionit.

Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? Nuk abstenon.  
Kalon amendamenti.

9-shi u eliminua me propozim të Komisionit funksional dhe e votuam. Ishim të qartë.

Tash kemi amendamentet 10 deri 22, të gjitha të Komisionit funksional.

Kush është t'i votojmë në pako këto amendamente?

Urdhëroni, por për cilin amendament e kërkoni fjalën?

(Pas përgjegjes – pa kyçje të mikrofonit)

Ani, vijmë edhe te ai, nuk është i radhitur. Profesoreshë, unë pyeta për amendamentet që i kanë deputetët, por do t'ju dëgjoj dhe sidomos nëse është për amendamentin në procedurë.

Prandaj, ju pyes – kush është për t'u miratuar amendamentet 10 deri 22 të Komisionit funksional. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.  
A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.  
Miratohen amendamentet.

Urdhëroni profesoreshë.

EXHLALE SALIHU:

Zoti kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,  
Unë kërkoj falje që paraqitem pas kohe. Këtë amendament që e kam ofruar, e kemi diskutuar edhe në Komision, mirëpo kështu qysh thuhet “ajo rregullohet me statut”, kurse statuti rregullohet në bazë të ligjit. Atje, te neni 30, pika 2 shtohen fjalët – dhe e keni përpara, do të thotë te “drejtori”. Është fjala për drejtorin e institutit, në rregull është që të jetë bashkëpunëtor i lartë shkencor, por të jetë edhe i profilit të institutit përkatës. Mendoj se kjo është në të mirë të institutit dhe ma merr mendja se është krejt në rregull sipas mendimit tim. Dua të them – mos të jetë në kimi drejtor një gjeograf, në institutin e kimisë, sepse

logjikisht duhet të jetë i profilit të institutit përkatës, për të qenë më efektiv. Këtë desha ta them, dhe mendoj se këtu kurgjë të keqe nuk ka.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, unë plotësisht ju përkrahi. Unë i thash edhe kryetarit të Komisionit të buxhetit: nuk është amendament i radhitur, nuk e kanë patur deputetët, prandaj kjo mund të amendamentohet për seancat e para, në qoftë se tregohet në praktikë dhe më lehtë është atëherë se ta thejmë procedurën tani.

Duhet tani ta votojmë në tërësi ligjin e amendamentuar.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Konsideroj se Ligji u miratua.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Kalojmë në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për tubimet publike.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për tubimet publike ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për tubimet publike me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për tubimet publike me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional si dhe të deputetëve Bujar Dugolli dhe Hydajet Hyseni.

Amendamenti 1, Hydajet Hyseni pa përkrahje nga Komisioni funksional.  
Ma mirë do t'ishte të numërohen votat. 10 deputetë janë për.  
Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 2 Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? Nuk abstenon askush.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? Nuk ka abstenime.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, deputeti Dugolli, pa përkrahje të Komisionit funksional.  
Kush është për? Ju falemnderit. 11 vota janë për.  
Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 5, deputeti Dugolli, pa përkrahje të Komisionit funksional.

Urdhëro, urdhëro – si jo.

#### BUJAR DUGOLLI:

Nejse, për 4-shin nuk u lajmërova, por kur është fjala për përkufizimet për 5-shin, mendoj se Komisioni nuk e ka analizuar sa duhet, sepse këtu në amendament sqarohet diçka që duhet të ekzistojë të tubimet, sepse nuk mundet kur të dojë policia - pa paralajmërime të ndërhyjë në kurrfarë tubimi. Prandaj, paralajmërimet janë të nevojshme sepse mund të ketë – në mesin e tubimit apo demonstratës - individ të caktuar që e thejnë rendin dhe mund të ketë tjerë që janë krejt paqësor, dhe duhet të paralajmërohen ata që janë paqësor, sepse në mesin e tyre ka të tillë që në rast se nuk eliminohen, atëherë do të intervenon policia. Paralajmërimi ekziston çdokund në botë për çdo tubim, dhe mendoj se në këtë ligj duhet të futet kjo dhe se duhet të tërhiqet vërejtja apo paralajmërimi në rast të rrezikut të rendit dhe qetësisë publike. Prandaj mendoj se ky amendament duhet të përkrahët i tillë nga Kuvendi. Falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Edhe një herë dëgjuat arsyeshmërinë e propozuesit. Megjithatë, unë dua të veproj sipas rregullave.

Do të thotë amendamenti 5, deputeti Dugolli me sqarimet që i dha, pa përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për? 19 vota për.  
Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.  
Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, deputeti Hyseni, me përkrahje të Komisionit funksional, vetëm për paragrafin 2.

Ju lutem, unë jam i obliguar ta komentoj kështu si shkruan, prandaj ju ftoj të deklarohe mi për amendamentin 7.

Kush është për?  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.  
Kush është për?  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? 1 abstenim.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, deputeti Hyseni, me përkrahje të Komisionit funksional.  
Kush është për?  
A ka kush kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, deputeti Dugolli, pa përkrahje nga Komisioni funksional.  
Kush është për?  
Urdhëroni zoti deputet.

#### BUJAR DUGOLLI:

Unë e kam vërejtur këtë në leximin e parë dhe kam deklaruar këtu se në rast që këto mbesin si janë në ligj, atëherë në një anë po lejohet e drejta e tubimit – protestës, prandaj nëse mbesin këto nene dhe nuk i heq nga ligji, prap e ndalon. Sidomos për specifikat që i ka vendi ynë dhe kryeqyteti jonë, mendoj se liria e tubimit, e shprehjes së mendimit, e protestës – është liri e garantuar dhe e drejtë n dërkombëtare, prandaj tubimi mund të mbahet si protestë edhe në oborrin e

spitalit dhe ta mbajnë punëtorët e spitalit nëse janë të pakënaqur me atë mbarvajtjen e punës, mund të mbahen edhe në oborrin e shkollës së mesme. Ne e kemi hequr vetëm te qerdhet dhe tek objektet ku mund të mbahet edhe në rrugë në rast se është detyrë e policisë të mbajnë rend dhe të gjejë alternativa, prandaj këto nene mendoj se duhet të fshihen, sepse në njërin anë ne e ndalojmë dhe bëjmë një shkelje të të drejtës së qytetarëve për të protestuar në vendin ku ata kërkojnë. Mendoj se këto duhet të fshihen dhe t'i lëhet mundësia sepse çdo qytetar ka të drejtë të protestojë edhe në oborrin e Kuvendit – administrata e Kuvendit dhe ne nuk mund ta ndalojmë por duhet t'iu lëmë hapësirë – mundësi për ta gëzuar këtë drejtë.

#### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bujar, të falemnderit. Dëgjuat arsyetimin. Duhet të procedojmë sipas rregullave.

Edhe një herë – amendamenti 10, deputeti Dugolli, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? 13 vota për.  
Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 11, deputeti Dugolli, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional.

Kush është për?  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
Abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, deputeti Bujar Dugolli, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?  
A ka kush kundër? Nuk ka.  
Abstenime? Nuk ka.  
Kalon amendamenti.

Dhe kanë mbetur amendamentet prej 14 deri 16 të Komisionit funksional.

Kush është për këto amendamente?

A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Kalojnë që të tri amendamentet.

Tash ju ftoj për votim të përgjithshëm të ligjit të amendamentuar.

Kush është për? Falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
Abstenime? Nuk ka.  
Konsideroj se Ligji është i aprovuar.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All  
Kundër – Protiv – Against.....00  
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Kalojmë në pikën e radhës – Shqyrtimi i Projektligjit për zejtarinë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për zejtarinë, sikur është deklaruar sot, nuk ka pengesë ligjore dhe ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për zejtarinë me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për tregti dhe industri, si Komision funksional e raportues i rekomandon Kuvendit të Kosovës që ta miratojë Projektligjin për zejtarinë, sipas tekstit të miratuar në shqyrtim të parë.

Do të thotë, Komisioni funksional ka këtë mendim.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit për buxhet.

Edhe një sqarim. Komisioni funksional kërkon që të rrespektohet vetëm versioni i parë, kurse Komisioni për buxhet i ka këto amendamente:

Amendamenti 1, Komisioni i buxhetit.  
Kush është për? Shumica absolute. Ju falemnderit.

Kush është kundër? S'ka asnjë kundër.  
A ka abstenime? 3 abstenime.  
Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni i buxhetit.  
Kush është për?  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? 1 abstenim.  
Kalon amendamenti.

Dhe Amendamenti 3, Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A abstenon kush? Askush nuk abstenon.  
Kalon amendamenti.

Kush është për aprovimin e ligjit me amendamentet e aprovuara? Ju falemnderit.  
A ka votë kundër? Nuk ka.  
A ka abstenime? Nuk ka.  
Ju falemnderit.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All  
Kundër – Protiv – Against.....00  
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

(Ndërprerje sipas inçizimit në CD)



Unë pata një konsultim me profesor Sejdiun dhe tani ju pyes: a jeni që ta bëjmë një pauzë gjysmëorëshe dhe pastaj ta vazhdojmë, apo që të vazhdohet seanca.

Jeni që të vazhdohet? Në rregull. Ju falemnderit.

(NË VAZHDIM, SEANCËN E KRYESON BASHKËKRESUESI FATMIR SEJDIU)

BASHKËKRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Vazhdojmë me punën.

Në radhë është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe drejtat e afërta.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për të drejtat e autorit dhe drejtat e afërta, me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta, me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Këto amendamente i keni para veti, dhe vazhdojmë shqyrtimin e tyre.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Të nderuar deputetë, siç keni tekstin para veti, nëse pajtoheni do të shkojmë në bllok miratimin e të gjitha amendamenteve të paraqitura nga Komisioni funksional dhe të njëjtat i ka radhitur si propozim.

Prandaj i vë në votim amendamentet 2 gjer në amendamentin 29,

Kush është për miratimin e këtyre amendamenteve? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

Abstenime? Nuk ka.

Meqë patëm një pajtim të përbashkët për amendamentet e propozuara - të radhitura për Projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejta te afërta, tani pyes:

- Kush është për miratimin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se njëzërit u miratua Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërta.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Kalojmë në pikën vijuese: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për librin amzë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislaion dhe kornizë kushtetuese, sot - ka vlerësuar se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me kornizën kushtetuese dhe ka mbështetjen ligjore.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për për librin amzë me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për librin amzë, me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se është miratuar amendamenti 1.

Të nderuar deputetë, meqë në këtë Projektligj janë dhënë 5 amendamente, të gjitha të Komisionit funksional, pyes – a pajtoheni t'i votojmë të gjitha amendamentet përnjëherë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se u miratuan amendamentet e propozuara në Projektligjin për librin amzë.

Lus deputetët të deklarohen për Projektligjin në tërësi për librin amzë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A është kush kundër? Askush.

A abstenon kush? Askush.

Konstatohet se njëzërit u miratua Ligji për librin amzë.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Në vijim është: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazetën zyrtare të Kosovës.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për gazetën zyrtare të Kosovës ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për gazetën zyrtare të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për gazetën zyrtare të Kosovës me amendamentet e propozuara nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional dhe të deputetit Mahir Jaghillar.

Në fakt këtu kemi një të vetmin amendament. Është amendamenti numër 1, deputeti Mahir Jaghillar, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka kush kundër? Nuk ka.  
Abstenime? Nuk ka.  
Konstatohet se u miratua amendamenti i propozuar.

Dhe, tani ftoj deputetët të deklarohen për Projektligjin për gazetën zyrtare të Kosovës.

Kush është për? Ju falemnderit.  
A ka kush kundër? Nuk ka.  
A abstenon ndokush? Askush.

Konstatohet se me mbështetje të tërësishme të deputetëve, që janë gjithsej 67 në sallë, u miratua Ligji për gazetën zyrtare të Kosovës. Ju falemnderit.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For ..... Të gjithë – Svi - All  
Kundër – Protiv – Against.....00  
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Në radhë është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat me amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Të nderuar deputetë, para vetes kemi 3 amendamente të cilat janë proceduar me pajtimin e plotë të Komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Këtu kemi edhe dy amendamente të tjera dhe duke patur parasysh një praktikë të themi të përbashkët, me pajtimin tuaj, i vë të dyjat në votim – am bllok.

Kush është që amendamentet 2 dhe 3 të propozuara nga Komisioni funksional të miratohen. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se njëzërit u miratuan edhe këto dy amendamente.

Tani e vë në votim Projektligjin për administratën tatimore dhe procedurat si tërësi, me amendamentet e propozuara.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Konstatohet se u miratua Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Në radhë është pika e rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentime.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, në mbledhjen e sotme ka dhënë pëlqimin dhe ka vlerësuar se Projektligji për patentime ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për patentime dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për patentime dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se u miratua amendamenti.

Të nderuar deputetë, amendamentet në vijim prej 2 deri 8 janë amendamente të propozuara nga Komisioni funksional dhe si të tilla i janë propozuar Kuvendit për miratim.

Duhet të deklarohemi për miratimin e amendamenteve prej 2 deri 8.

Kush është për që këto amendamente, prej 2 deri 8, të miratohen në tërësi?

Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se u miratuan edhe amendamentet 2,3,4,5,6,7 dhe 8 të paraqitura në Projektligjin për patentime.

Tani vë në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Konstatohet se Kuvendi miratoi Projektligjin për patentime.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

---

Në radhë është shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka dhënë mendimin e vet dhe ka vlerësuar se Projektligji për shërbimin privat në shëndetësi ka bazueshmërinë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për për shërbimin privat në shëndetësi dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Konstatohet se u miratua amendamenti 2.

Të nderuar deputetë, në vijim – sikur edhe dy amendamentet e para – janë amendamente të radhitura deri në numrin 47 dhe të gjitha të Komisionit funksional.

Lidhur me këtë mund të syzozojmë se është arritur pajtim unanim i Komisionit dhe ju ftoj të deklarohe mi bashkërisht lidhur me amendamentet prej 3 deri 47.

Kush është për, që këto amendamente të miratohen? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Më lejoni të konstatoj se Kuvendi mbështeti me votim të njëzëshëm të gjitha amendamente te propozuara nga ana e Komisionit funksional.

Tani vë në votim Projektligjin për shërbimin privat në shëndetësi bashkë me amendamentet e propozuara.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Ju falemnderit.

Konstatohet se Kuvendi me tërësinë e votave të deputetëve prezent miratoi Projektligjin për shërbimin privat në shëndetësi.

Tani propozojmë të bëjmë një pauzë, me syzjerim të deputetëve dhe të Grupit Parlamentar të Aleancës, deri në orën 13,30.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Lus regjinë edhe një herë që t'i ftojë deputetët të vijnë në sallë.

(Ndërprerje)

Më lejoni t'ju informoj se duhet ta përmbyllim Seancën plenare dhe punën e kësaj përbërjeje të Parlamentit. Nuk kemi kuorum të mjaftueshëm që ta vazhdojmë punën!

Unë, me sinqertësinë më të madhe, ju falënderoj për punën që kemi bërë bashkërisht këto vite, për rezultatet e arritura që sipas një segmenti ose një sfare janë të vogla, dhe ne vlerësojmë se kemi arritur një optimum në rrethana të veprimit dhe të funksionimit të institucioneve tona.

Falënderoj të gjitha grupet parlamentare, nën një – ani që është koha elektorale tash – Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Edhe Partinë Demokratike të Kosovës, e cila nuk është në sallë, pa asnjë arsye. Në fillim të Seancës u bë e qartë, edhe pse s'ishim të mendimit të votojmë, kurse unë thash këtë do ta bëjmë kur të vijmë në atë pikë të rendit të ditës. Megjithkëtë, i falënderoj për kontributin që kanë dhënë.

Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, po ashtu e falënderoj.

Dhe, jo në fund të fundit, por ndoshta të parët është dashur ta falënderoj Grupin Parlamentar të Bashkësive Joshqiptare dhe Joserbe, që me angazhimin e vet të sinqertë dhe serioz, shpeshherë kanë bërë edhe të pamundurën, e ndonjëherë edhe i kanë tejkaluar shumë probleme edhe brenda Grupit.

(Duartrokitje)

Prandaj, dëshiroj që këto tri vite do të jenë themel i mirë, unë them gjithmonë i unitetit veprues të një parlamenti. Dhe, deshti apo nuk deshti me pranuar në deklaratat e tij zoti Xhavit Haliti – kolegu im nga Kryesia e Parlamentit, ky Parlament ka qenë Parlamenti më i mirë në rajon dhe në Evropën Juglindore.

(Duartrokitje)

Dhe, ky nuk është vlerësim vetëm i imi. Kemi patur parlamente që kemi mund të m arrim yrrnek edhe tjetërfare. Por, në një rrethanë çfarë ishte konstituimi, mendoj se është krijuar një bazë e mirë ligjore dhe politike që zgjedhjet të jenë të qeta, fer dhe demokratike dhe implementimi i tyre do t'na shkojë më shpejt.

Unë kam menduar që në përfundim do ta pijmë nga një kafe bashkërisht, por këtë propozim nuk po e hudhi posht. Do t'ju ftoj me rastin e kryerjes – inaugurimit të hyrjes kryesore të Parlamentit, që do të jetë gjatë këtij mandati tonë, dhe atëherë do ta pijmë nga një kafe relaksuese.

Ju falenderoj për pjesëmarrje dhe u pafshim në parlamentin tjetër.

(Duartrokitje)

Seanca përfundoi punimet në orën 13,45